



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 27.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.93/2015, “PËR TURIZMIN”, TË NDRYSHUAR”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 27.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

Nga projektligji dhe relacioni shpjegues që shoqëron rezulton se qëllimi i projektligjit është për të mos lejuar përfitimin, mbështetjen dhe lehtësitë e parashikuara nga ligji jo vetëm për investitorët/operatorët menaxhues, të cilët janë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e disa veprave të rënda penale, por edhe për personat e dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë që janë anëtarë të një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, apo që

kanë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda investitorit/operatorit menaxhues.

III. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE DHE RIFORMULIME SIPAS NENEVE

Në përfundim të shqyrtimit dhe diskutimit të projektligjit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji, si dhe në miratimin në tërësi të projektligjit, miratoi dhe i përcjell komisionit përgjegjës këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

1. “Në paragrafin e parë të pikës 2, fjalët *“kur ka të dhëna se”* zëvendësohen me fjalën *“nëse”*;

2. Me qëllim formulimin e qartë si dhe duke marrë parasysh në listimin e veprave penale, përputhshmërinë me Kodin Penal, shkronjat “d” dhe “ë” të pikës 2 të nenit riformulohen si vijon:

“d) Vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;
ë) Shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.”

3. Në pikën 3 të nenit, togfjalëshi *“vërtetim nga dosja gjyqësore”* të zëvendësohet me togfjalëshin *“vërtetim mbi gjendjen gjyqësore”*.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, konstatoi se :

- Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

Edmond LEKA

KRYETAR

ULSI MANJA